

Si u krijua njerëzimi

Së pari dëshiroj t'u përcjell të gjithëve përshëndetjet e mia për ardhjen e Vitin të Ri Kinez.

Viti i Ri normalisht do të ishte një kohë për të ndarë disa shkëmbime të këndshme me këtë rast. Por unë shoh një rrezik të afërt që po i kanoset njerëzimit dhe për këtë arsye qeniet hyjnore më kanë kërkuar që t'i përcjell të gjithëve në këtë botë disa gjëra. Secila nga këto që do të zbuloj është një sekret më i lartë, shumë i ruajtur, dhe ato po ndahen me ju për t'ju dhënë një pamje të vërtetë të situatës dhe për t'i dhënë njerëzve një shans tjetër për shpëtim.

Së pari është pyetja se si lindi njerëzimi. Nga fillimi i krijimit të tij deri në ditët e tij të fundit, universi ka kaluar nëpër një kohë jashtëzakonisht të gjatë të përbërë nga katër faza: Formimi, Stabiliteti, Degjenerimi dhe Shkatërrimi. Kur arrihet pika përfundimtare e fazës së Shkatërrimit, zhdukja e plotë e gjithçkaje në trupin më të madh kozmik—që përfshin universin në të cilin ne ekzistojmë—ndodh njëkohësisht dhe *të gjitha* gjallesat zhduken!

Kur një person vdes, bëhet fjalë vetëm për rrënimin dhe shpërbërjen e trupit të tij fizik, ndërsa shpirti i tij i vërtetë (i cili është ai që personi është në të vërtetë dhe që nuk vdes me vdekjen e trupit të tij fizik) do të vazhdojë në një jetë tjetër, duke u rilindur. Pra, ashtu si universi kalon përmes formimit, stabilitetit, degjenerimit dhe shkatërrimit, po ashtu edhe qeniet njerëzore kalojnë përmes lindjes, plakjes, sëmundjes dhe vdekjes. Këto janë ligje të universit, të cilave u nënshtrohen edhe qeniet më të larta, vetëm se hapësira kohore është më e gjatë, me një proces që është më i zgjatur në raport me sa të larta janë ato qenie. Jeta dhe vdekja nuk janë të dhimbshme për ta, dhe ata mbeten të vetëdijshëm gjatë gjithë këtyre proceseve—për ta është sikur po ndryshojnë veshjen. E thënë ndryshe, normalisht jetët nuk vdesin vërtet. Por kur universi dhe kozmosi shpërbëhen në fazën përfundimtare të procesit të Formim- Stabilizim- Degjenerim-Shkatërrim, jetët nuk do të rilindin dhe nuk do të ketë më ekzistencë

të jetës apo materies, me gjithëshka që shndërrohet në pluhur dhe ajo që mbetet është vetëm zbrazëti. Aktualisht bota njerëzore po përjeton periudhën e fundit të fazës së Shkatërrimit të progresionit të Formimit, Stabilizimit, Degjenerimit, Shkatërrimit. Gjithçka ka ndryshuar për keq në këto kohë të fundit, siç është e caktuar nga fati, dhe kështu shkatërrimi është i pashmangshëm. Dhe kjo është arsyeja që bota është kaq e trazuar. Mendimet e mira janë të rralla, mendjet e njerëzve janë shtrembëruar, shthurja dhe abuzimi me drogën janë të shfrenuara dhe njerëzit pajtohen me ateizmin. Këto janë të pashmangshme në fazën e fundit të kozmosit, dhe janë indikative për kohën ku kemi mbërritur!

Krijuesi i çmon të gjitha qeniet qiellore që ekzistojnë, si dhe të gjitha jetët që janë të virtytshme dhe zemërmira, dhe të gjitha krijimet e lavdishme në kozmos. Kështu, në fillim të fazës së Degjenerimit Ai udhëhoqi një numër qeniesh hyjnore në rrafshin më të jashtëm të trupit kozmik (i njohur përgjithësisht si "ajo që është jashtë Mbretërisë Hyjnore"), një vend ku nuk ka qenie hyjnore dhe krijoi Tokën. Por Toka nuk kishte kapacitetin për të ekzistuar në mënyrë të pavarur; duhej që të ekzistonte një strukturë kozmike që i korrespondonte me të cilën mund të formonte një sistem qarkullimi që përfshin jetë dhe materien. Për këtë arsye, Krijuesi krijoi një hapësirë më të madhe jashtë Tokës, të cilës qeniet më të larta i referohen si "Tre Mbretëritë". Para se të vinte koha e fundit e shpëtimit, asnjë qenie e lartë, sado e lartësuar, nuk lejohej të hynte ose të dilte nga kjo hapësirë pa lejen e Krijuesit. Hapësira e Tre Mbretërive përfshin tre sfera kryesore: Mbretëria e Dëshirës (*yu*), e cila përbëhet nga jetët në këtë tokë, duke përfshirë njerëzimin; një mbretëri e dytë, Mbretëria e Pëlqimeve (*se*), e cila është mbi të; dhe një mbretëri e tretë, më lart, e njohur si Mbretëria Pa Pëlqime (*wu se*). Çdo mbretëri e njëpasnjëshme është më e lartë dhe më e lavdishme se ajo poshtë saj, megjithëse asnjë nuk mund të krahasohet me Mbretërinë Hyjnore apo me mbretëritë qiellore të shumta ende më të larta. "Qielli" të cilit normalisht njerëzit i referohen është në fakt ose brenda Mbretërisë së Pëlqimeve ose Mbretërisë Pa Pëlqime, brenda Tre Mbretërive. Secila nga Tre Mbretëritë ka dhjetë rrafshe brenda saj, duke bërë gjithsej tridhjetë e tre rrafshe, nëse përfshini dhe vetë tre mbretëritë. Qeniet njerëzore banojnë në Mbretërinë e Dëshirave, dhe kjo është më e ulta nga të gjitha rrafshet, me mjedisin më të keq. Jeta është e

dhimbshme dhe e shkurtër këtu, por akoma më i tmerrshëm është fakti se në botën njerëzore pak nga gjërat që njerëzit i konsiderojnë të vërteta janë në të vërtetë të tilla. Ajo që qeniet njerëzore mendojnë të jetë e vërtetë në përgjithësi konsiderohet e kundërta në universin më të madh (por një përjashtim janë të vërtetat më të larta që qeniet e shenjta i kanë mësuar njeriut). Për shembull, hyjnorja nuk e konsideron të drejtë që kushdo që fiton në betejë të bëhet sundimtar, që territori të kapet me forcë ushtarake ose që të fuqishmit të shihen si heronj—pasi këto përfshijnë vrasjen dhe marrjen me forcë nga të tjerët. Kjo nuk është mënyra e universit, as se si qeniet më të larta i bëjnë gjërat. Megjithatë në botën njerëzore këto janë të pashmangshme dhe të pranuar. Këto janë mënyrat e botës njerëzore, por ato janë në kundërshtim me mënyrat e universit. Kështu, nëse një person dëshiron të kthehet në parajsë, ai duhet të ndjekë ligje të vërteta, më të larta dhe të punojë për veten e tij. Disa njerëz janë të kënaqur kur janë pak më mirë në jetë se të tjerët. Por njerëz të tillë po e krahasojnë veten vetëm me qeniet e tjera njerëzore brenda kësaj sfere njerëzore, kur të gjithë këtu jetojnë në fakt në atë që konsiderohet si koshi i plehrave të universit. Tre Mbretëritë u krijuan në perimetrin më të jashtëm të trupit kozmik dhe gjithçka këtu përbëhet nga grimcat më të ulëta, më të papërpunuara dhe më të papastrat—molekulat, atomet dhe ato të ngjashme me to. Në sytë e qenieve më të larta, këtu hidhen mbeturinat e universit. Kështu ato e konsiderojnë këtë plan molekulash si pluhur ose "baltë" dhe e shohin atë si pjesën më të ulët. Kjo është origjina e besimit të mbajtur në disa fe se njeriu u krijua nga hyjnorë nga balta. Njeriu me të vërtetë u formua nga materia në rrafshin molekular.

Kur qeniet hyjnore krijuan njeriun, ata e bënë këtë me urdhër të Krijuesit dhe Ai i udhëzoi që secila të krijonte qenie njerëzore sipas imazhit të vet unik. Për këtë arsye ekzistojnë raca e bardhë, aziatike, e zezë dhe raca të tjera. Ndërsa pamjet e tyre të jashtme ndryshojnë, shpirtrat brenda tyre u dhanë nga Krijuesi. Dhe kjo është arsyeja pse ata kanë vlera të përbashkëta. Qëllimi që Krijuesi kishte në drejtimin e qenieve hyjnore për të krijuar njeriun, ishte të përdorte njeriun në kohët e fundit kur Ai do t'i ofronte të gjitha jetëve të universit më të madh—duke përfshirë qeniet e shenjta—shpëtimin.

Por pse Krijuesi do t'i bënte qeniet hyjnore t'i krijonin njerëzit në një vend kaq të ulët dhe inferior? Kjo për arsye se, duke qenë se ky është rrafshi më i ulët i universit, ai është vendi më rraskapitës dhe vetëm kur gjërat janë të vështira dhe të dhimbshme, mundet që një person të lartësojë veten përmes praktikës shpirtërore dhe të heqë karmën e tij ose të saj. Kur një person, mes përvojave të dhimbshme, ende arrin të mbajë mendime të mira, të ketë mirënjohje dhe të jetë një njeri i mirë, ai ose ajo po rritet përmes kësaj. Shpëtimi është një proces i ngritjes nga e ulëta në të lartë, dhe kështu njeriu duhet të fillojë nga fundi. Jeta është e vështirë për këdo që jeton këtu. Ka tensione midis njerëzve kur ata përpiqen të dalin më mirë, është gjendja e tmerrshme e mjedisit natyror dhe është fakti që vetëm për t'ja dalë mbanë në jetë kërkon shumë mendim dhe përpjekje, për të përmendur vetëm disa shembuj. Të gjitha këto rrethana u ofrojnë njerëzve mundësi për të zhvilluar veten dhe për të pakësuar karmën e tyre. Është e sigurt që kalimi i vështirësive mund t'i ndihmojë njerëzit të shlyejnë mëkatet dhe karmën e tyre. Dhe kushdo që arrin të qëndrojë i sjellshëm mes situatave të dhimbshme dhe telasheve ndërpersonale do të krijojë merita dhe virtyt dhe, si rezultat, do të arrijë lartësimin e shpirtit të tij ose të saj.

Me ardhjen e kohëve moderne, Krijuesi kishte synuar të përdorte kryesisht trupin e njeriut për të shpëtuar jetët e shumta të universit. Dhe kështu shpirtrat fillimisht në shumicën e trupave njerëzorë këtu u zëvendësuan nga ata të qenieve më të larta, të cilat u ringjallën në to. Me një trup njerëzor ata mund të zvogëlonin karmën dhe mëkatet e tyre duke duruar vështirësitë. Dhe në këtë vend që nuk ka të vërteta, ata mund të arrinin lartësimin e shpirtit të tyre, duke u mbajtur fort në të vërtetat më të larta të mësuara nga Zoti dhe duke këmbëngulur në mirësi dhe mëshirim. Kohët e fundit kanë arritur tashmë tek ne dhe Porta Qiellore që të nxjerr jashtë Tre Mbretërive është hapur. Krijuesi ka zgjedhur për çlirim ata që kanë bërë siç po e përshkruaj unë.

Gjithçka në univers ishte bërë e papastër gjatë fazave të Formimit, Stabilitetit dhe Degjenerimit dhe inferiore në krahasim me fillësën e krijimit. Dhe kjo është arsyeja pse gjërat po shkojnë drejt Shkatërrimit. Me fjalë të tjera, gjithçka në universin e madh është prishur, jetët e krijuara nuk janë më aq të mira sa në fillimet e tyre, nuk janë më të pastra, dhe ato të gjitha kanë grumbulluar karma

dhe mëkate. Dhe kjo është arsyeja për Shkatërrimin që po vjen. Ky lloj mëkati është ai që është referuar në kontekstet fetare si mëkati origjinal. Në mënyrë që universi të mund të shpëtohej, Krijuesi udhëzoi një mori qeniesh të larta dhe sovranë hyjnore që të zbrisnin në tokë dhe të merrnin formë njerëzore në këtë mjedis, ku ata do të vuanin, do të lartësoheshin, do të shlyenin mëkatet e tyre dhe do të krijonin veten përsëri—duke u ringjitur në qiell si rezultat. (Krijuesi ka qënë duke ribërë universin në të njëjtën kohë që shpëtonte njerëzimin.) Universi i ri është krejtësisht i pastër dhe thjesht i madhërishëm. Nëse, në një mjedis të vështirë si ky, një person mund t'i mbajë ende të virtytshme mendimet e tij; nëse ai mund t'i rezistojë sulmit nga vlerat dhe pikëpamjet moderne dhe t'u përmbahet atyre tradicionale; dhe nëse ai ende beson në hyjnoren përballë sulmeve nga kampet ateiste dhe evolucionare, atëherë ai person do ta përmbushë qëllimin e tij: të fitojë shpëtimin dhe të kthehet në parajsë. E gjithë çmenduria që po shpaloset tani në botë ishte planifikuar si e tillë, për fazën përfundimtare, nga qeniet hyjnore. Qëllimi i tyre ishte të testonin jetët këtu dhe të shihnin nëse ato ishin të denja për shpëtim dhe t'u jepnin atyre një shans që, në këtë proces, të hiqnin mëkatet dhe karmën e tyre ndërsa kalonin vështirësi. Dhe e gjithë kjo u bë në mënyrë që njerëzit të mund të shpëtoheshin dhe të fitonin çlirimin duke u kthyer në parajsë.

E gjithë kjo do të thotë se qëllimi i jetës së njerëzve në këtë tokë nuk është të realizojnë diçka në botë. Të gjitha përpjekjet dhe veprimet intensive që njerëzit bëjnë në jetë, dhe dëshira e tyre për të marrë atë që duan, që mund të përfshijë edhe përdorimin e mjeteve të paskrupullta, vetëm se i bëjnë njerëzit imoralë në fund. Arsyeja pse njerëzit erdhën në këtë botë dhe u bënë njerëz ishte për të shlyer mëkatet dhe karmën e tyre dhe për të bërë përparim të rëndësishëm shpirtëror. Njerëzit erdhën në këtë botë për të fituar shpëtimin. Ata erdhën dhe morën formën njerëzore për të pritur Krijuesin dhe shpëtimin e tij dhe për t'u kthyer në mbretërinë e tyre qiellore. Dhe ndërsa ata prisnin, ata grumbulluan merita gjatë shumë jetëve të tyre të kaluara; dhe ky ishte qëllimi i ringjalljes së njerëzve. Natyra e trazuar e kësaj bote ka për qëllim të krijojë diçka të mrekullueshme nga këto jetë. Sigurisht, ka disa njerëz që, kur kërkojnë ndihmë hyjnore në kohë vështirësish, nuk kanë qenë të kënaqur me rezultatin dhe kanë

filluar ta urrejnë Perëndinë, madje duke u kthyer kundër Tij si rezultat. Disa madje janë kthyer në anën demonike, të errët, dhe kanë kryer akoma më shumë mëkate dhe kanë grumbulluar akoma më shumë karma. Ata të cilëve u përket kjo situatë, bëjnë mirë të bëjnë kthesë të shpejtë dhe t'i luteshin Perëndisë për falje, nëse do të kishin ende një shans për të arritur sigurinë. Çdo gjë që ndodh në jetën e dikujt—pavarësisht nëse duket e merituar apo jo—është, në realitet, pasoja karmike e asaj që dikush ka bërë në jetën e tij të kaluar, për mirë ose për keq. Sasia e bekimeve dhe virtytit që dikush ka krijuar në jetët e mëparëshme përcaktojnë se çfarë prosperiteti do të ketë në këtë jetë, ose ndoshta në tjetrën. Nëse dikush jeton një jetë të bekuar dhe të virtytshme tani, ndoshta ajo do të përkthehet në një pozitë dhe pagë të lartë në jetën tjetër, ose mund të përkthehet në lloje të tjera pasurie dhe fati. Dhe kjo do të përfshijë gjithashtu nëse dikush ka një familje të lumtur, apo edhe si do të dalin fëmijët e tij, e kështu me radhë. Kjo është arsyeja themelore pse disa njerëz janë të pasur dhe të tjerë të varfër, pse disa mbajnë poste të larta, ndërsa të tjerët janë të varfër dhe të pastrehë. Nuk është asgjë si marrëzia djallëzore që nxjerr komunizmi ogurzi për barazinë mes të pasurve dhe të varfërve. Universi është i drejtë. Ata që bëjnë mirë janë të bekuar për të, ndërsa ata që bëjnë gjëra të këqija do të përballen me shpagimin—nëse jo në këtë jetë, atëherë në tjetrën. Sepse ky është një ligj i pandryshueshëm i universit! Qielli, Toka, Hyjnorja dhe Krijuesi janë njësoj të mëshirshëm për të gjitha jetët. Qielli dhe Toka, ashtu si dhe njeriu, u krijuan nga Krijuesi dhe nuk ndodh kurrë që Ai të favorizojë disa jetë dhe t'i hyjë në hak disa të tjerëve. Arsyeja pse disa njerëz bëjnë jetë të lumtur dhe të tjerë jo rezultojnë në shpërblime dhe ndëshkime për veprat e kaluara.

Kur sheh njerëz që fitojnë ose humbasin në jetë, duket sikur kjo vjen në mënyrë normale nga gjërat në këtë botë. Por në fund të fundit janë pasojat karmike të veprimeve në të kaluarën të këtyre njerëzve. Nëse njerëzit kanë diçka apo jo, ose po fitojnë apo humbasin në jetë, do të luhet në mënyra që përputhen me këtë botë. Pra, pavarësisht nëse je i pasur apo i varfër në jetë, duhet të sigurohesh që të bësh të mira, të përmbahesh nga të bërit të gjërave të këqija, të qëndrosh i mirë dhe i sjellshëm, të jesh shpirtëror dhe i devotshëm dhe të jesh i lumtur të

ndihmsh të tjerët. Dhe duke vepruar kështu, ju do të grumbulloni bekime dhe virtyt dhe do të merrni shpërblimet prej tyre në jetën tjetër. Në të kaluarën, brezi i vjetër në Kinë fliste shpesh për gjëra të tilla si mos të ankoheni për fatin tuaj në jetë kur gjërat janë të vështira dhe për të fituar një jetë më të mirë në të ardhshmen duke fituar virtyt përmes veprave të mira. Dhe çështja ishte se është e kotë t'i lutesh Zotit për ndihmë nëse nuk ke bërë gjëra të mira në jetën tënde të mëparshme dhe nuk ke fituar bekime. Universi ka ligjet e tij dhe qeniet edhe më të larta duhet t'u binden atyre. Edhe ata do të ndëshkohen nëse bëjnë gjëra që nuk duhet. Pra, gjërat nuk janë aq të thjeshta sa i mendojnë njerëzit. A duhet të presin njerëzit që qeniet e larta t'u japin atyre çdo gjë për të cilën lutën? Parakushti është që njeriu duhet të ketë grumbulluar bekimet dhe virtytin gjatë jetëve të kaluara për t'i marrë ato. Dhe kështu gjërat që ju vijnë janë për shkak të bekimeve dhe virtytit që keni! Kjo është ajo që diktojnë ligjet e universit. Por duke folur në një nivel më themelor, marrja e asaj që dëshironi nuk është qëllimi përfundimtar i grumbullimit të bekimeve dhe virtytit. Qëllimi i vërtetë i grumbullimit të tyre është t'ju hapë rrugën e kthimit në parajsë. Dhe kjo është gjëja më e rëndësishme, jo momenti i shkurtër i lumturisë që ato mund t'ju sjellin në këtë jetë!

Mësuesi Hongzhi Li
20 janar 2023